



Departamenti i Prokurimit

Prishtine : datë,02.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.06.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Besa Security SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi i kamerave ne Institucionet Arsimore” me Nr. të Prok: 616 20 2907 121 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të “Besa Security SHPK” të dt. 29.06.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe montimi i kamerave ne Institucionet Arsimore” me Nr. të Prok: 616 20 2907 121, kundër Njoftimit për KONTRATE te AK –së, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “Besa Security SHPK” me datë 29.06.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi i kamerave ne Institucionet Arsimore” me Nr. të Prok: 616 20 2907 121 . Autoriteti Kontraktues, me datë 02.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

-Lidhur me pretendimin tuaj per largimin e kerkeses per certifikaten ISO/IEC 20000-1:2011 ju sqarojme se kerkesa e tille eshte vendosur duke u bazuar ne pervojen tone te keqe me furnizuesit dhe mirembajtesit e paisjeve nga kontratat e deri tanishme,pasi qe shpesh here duhet te presim me jave e ndoshta edhe me muaj derisa te servisohet ndonje produkt i blere nga kjo lemi dhe nga lemite e ngajshme.Pra nje certifikim i tille na siguron se te gjitha defektet ne

afatin garantues do te evitohen ne afate sa me te shkurta.Dhe kur eshte fjala per institucionet arsimore natyrisht se nuk mund te krijojme rrethanat per pritje afatgjate per sanime te defekteve.Pra kerkesa ka per qellim vetem qe te kemi nje garancion se furnizuesi do te jete ne gjendje ne cdo kohe qe te evitoj defektet eventuale.

Lidhur me pretendimin se kete certifikate e posedon vetem nje OE-ik ne kemi konsultuar ekspertet e TI-se ne Autoritetin tone dhe sipas tyre ka shume kompani serioze qe e posedojne kete certifikate qe d.t.th.se pretendimi juaj nuk eshte i sakte dhe i bazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit